



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:025483
Datë: 01.10.2024
Numri i dokumentit: 06338828

KF.nr.624/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit “Kastrati Group” ShPK me numër unik identifikues 810862723, me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, lidhur me padinë e paditësit për anulim vendimi-ndëshkim tatimor, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor- publik, të mbajtur me datë 18.09.2024 në prezencë të përfaqësuesit të paditësit, A.S. dhe në mungesë të përfaqësuesit të palës, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit, “Kastrati Group” ShPK me numër unik identifikues 810862723, me seli në Prishtinë, si e bazuar.
- II. ANULOHET vendimi nr.494/21 i datës 29.12.2021, i Departamentit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës dhe lënda kthehet në RISHQYRTIM DHE RIVENDOSJE tek e paditura.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi, me padinë e paraqitur në Gjykatë më datë 09.02.2022, ka inicuar kontestin tregtar-administrativ kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës së përgjithshme administrative, konstatimit jo të plotë të gjendjes faktike dhe ka zbatimin e gabuar të legjislacionit material. Si në padi, ashtu edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, përfaqësuesi i paditësit ka deklaruar se e paditura me datë 12.10.2021 ka kryer kontrollin tek paditësi dhe pas përpilimit të raportit në të cilin shkruajnë pretendimet për shkeljet e konstatuar raportin e dërgon në ZGJONA, e paditura bien konstatimin se paditësi ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe i shqipton gjobë prej 2,000.00 euro për shkak të gjoja mos mbajtjes së librave dhe regjistrimeve. Dispozitivi dhe arsyetimi i

këtij vendimi janë kundërthënëse me njëra tjetrën sepse e paditura në pjesë të shumta të raportit konstaton se paditësi ka pasur librat e shitjes dhe se të njëjtat janë kontrolluar, ndërsa në dispozitiv i shqipton gjobë për mos mbajtjen e tyre. Raporti përmban pretendime për rritje të qarkullimit shtesë në TVSH dhe CD ndërsa në asnjë pjesë të tij nuk përmendet se paditësi nuk ka pasur librat e shitjes, andaj e paditura ka vepruar edhe në kundërshtim me neni 90 par 2 të LPPA sepse në asnjë moment nuk e ka konsideruar të nevojshme deklarin e paditësit lidhur me këto pretendime. Njëkohësisht ka shkelur edhe nenin 94 dhe 95 të LPPA-së të cilat i japin mundësi paditësit që të dëgjohet si palë, të japë mendime si dhe prova e dokumente për procedurën përkatëse. Sa i përket përgjigjes në padi të njëjtën e kundërshtojmë në tërësi sepse edhe vet e paditura në faqen tre të saj ka theksuar se “ATK nuk ka thënë se nuk ka mbajtur libra por ka konstatuar se nuk ka mbajtur librat- regjistrimet sipas dispozitave andaj është gjobitur për nën deklarin” përmes kësaj e paditura pranon se veç se ka shqiptuar një gjobë për nën deklarin ndërsa në vendim i shqipton edhe gjobën tjetër për të njëjtën shkelje të pretenduar. Gjykatës i ka propozuar që të administrojë si provë edhe vendimin nr.492-2021 të datës 28.12.2021 meqenëse është një pretendim në përgjigjen në padi për lëndën konkrete, një kopje ia dorëzoi gjykatës. Gjykatës i ka kërkuar që të aprovojë në tërësi kërkesëpadinë dhe të anulojë vendimin e të paditurës ashtu që lënda të kthehet në rishqyrtim.

E paditura, në përgjigjen ndaj padisë të datës 19.08.2024, i ka kundërshtuar të gjitha pretendimet e paraqitura nga paditësi, duke i vlerësuar ato si të pabazuara në ligj dhe fakte materiale. Sipas ATK-së, vendimi i kontestuar i Divizionit të Ankesave është i drejtë dhe në përputhje të plotë me legjislacionin tatimor të aplikueshëm në Republikën e Kosovës. Ka shtuar se, paditësi ka pretenduar se ATK ka bërë një gabim në konstatimin e gjendjes faktike, duke aluduar se nuk ka mbajtur libra të shitjeve. Megjithatë, ATK nuk ka konstatuar mungesën e librave, por faktin që regjistrimet në libra nuk janë bërë sipas dispozitave ligjore. Për këtë arsye, paditësi është gjobitur për nën-deklarin në vlerë prej 5,951.81€. Gjithashtu, pretendimi i paditësit për ndëshkimin prej 2,000€ është i pabazuar, pasi gjoba është aplikuar sipas nenit 53 të ligjit për Administratën Tatimore, për shkak të mos mbajtjes së regjistrimeve siç parashikohet me ligj. Me përfundim se ATK ka vepruar drejt dhe në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, dhe vendimi i kontestuar është i bazuar në legjislacionin tatimor të Republikës së Kosovës.

Gjykata e ka shqyrtuar këtë kontest tregtar-administrativ në përputhje me dispozitat e nenit 41 të LKA-së, në mungesë të palës së paditur e cila përmes parashtresës së datës 19.09.2024 ka

njoftuar gjykatën se nuk do të marrë pjesë në seancë, duke kërkuar nga gjykata të veprojë në përputhje me nenin 38, paragrafi 5 të LKA-së.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurë të provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor - publik të datës 18.09.2024, ka administruar provat dhe atë: Përgjigje në padi e datës 19.08.2024, Vendim nr 494/21 dt 29.12.2021, Ankesë në DA të ATK-së me dt 08.11.2021, Vendimi i ZGJONA nr.2665/2021 dt 13.10.2021, Fletë kthesë e postës, Të dhënat nga ARBK-së për paditësin, Raporti i kontrollit i datës 12.10.2021, Vendimi nr.492-2021.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar administrativ, deklarimeve të paditësit gjatë shqyrtimit gjyqësor, bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar administrativ, deklarimeve në padi dhe përgjigjes në padi, shkresat e lëndës, vendimi kontestues, Gjykata ka gjetur se nuk është kontestuese fakti se e paditura ka ushtruar kontroll tek paditësi ku objekt i kontrollit kanë qenë periudhat 01/2019 deri 02/2021 për të gjitha llojet e tatimeve. Për shkak të parregullsive të konstatuara paditësi është ndëshkuar ashtu që Zyra për Gjoba dhe Ndëshkime Administrative me datë 13.10.2021, ka marr vendim nr.2665/2021 mbi shqiptimin e ndëshkimit administrativ në vlerë prej 2,000.00 €, për subjektin tatimor këtu paditësin, për mos mbajtje dhe mos krijim të regjistrave sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe për nen deklarim është gjobitur në bazë të nenit 52 par 1.2 prej 25% në vlerë prej 5,951.81 Euro. Ndaj këtij vendimi paditësi ka parashtruar ankesë të cilën e paditura me vendimin e kontestuar nr.494/2021 e ka refuzuar duke vërtetuar lëshimin e ndëshkimit nr.2665/2021 të datës 13.10.2021, respektivisht dokumenti mbi vendosjen e ndëshkimit në vlerë prej 2,000.00 euro sipas nenit 53 (53.2.4), është vërtetuar si i bazuar, ndërsa në pikën III ka vendosur: se për ndëshkimi prej 5,951.81 euro, për nen deklarim përgjigjen e keni në vendimin nr.492/2021 sipas ankesës me nr.protokolli 492/2021 të datës 09.11.2021. Ndaj këtij vendimi paditësi ka inicuar këtë konflikt administrativ.

Kontestuese mbetet çështja e bazës ligjore të ndëshkimit tatimor, nëse e paditura ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore të LPPA-së dhe nëse dispozitivi i vendimit kontestues është në përputhje me arsyetimin.

Nga vendimi kontestues gjykata konstaton se e paditura ka sqaruar se DA vërteton se tatimpaguesi mbetet obligues i këtij ndëshkimi për mos mbajtjen e regjistrimeve sipas nenit 13 të Ligjit 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligin nr.04L-102 dhe 04/L-223 dhe te nenit 17 pika 4 të UA 15/2020 për shkak të mos mbajtjes së librave dhe regjistrimeve, dhe për këto parregullsi ndëshkohet sipas nenit 53 të Ligjit 03/L-222 dhe nenit 43 pika 98.3 të UA nr.15/2010 dhe nenit 52 pika 1.2 të ligjit 03/L-222.

Gjykata me propozimin e palës paditëse ka administruar edhe vendimin nr.492/2021 të të paditurës meqenëse në pikën III të vendimit kontestues theksohet se përgjigja për ndëshkimin në shumë prej 5,951.81 euro gjendet në këtë vendim, respektivisht vendimin nr.492/2021. Megjithatë, nga leximi i këtij vendimi gjykata konstaton se i njëjti ka shqyrtuar ankesën ndaj raportit të kontrollit e me të cilin e paditura ka aprovuar pjesërisht ankesën dhe ka ndryshuar njoftim rivlerësimet për periudhën TVSH 12/2019, TVSH 12/2020, CD 2019 dhe CD/2020 në lidhje me qarkullimin shtesë prej 2 cent mbi kosto, i cili njoftim rivlerësim vërtetohet si i pabazuar dhe qarkullimi vendoset në çmimi e koston, ndërsa ka lënë në fuqi njoftim rivlerësimet e tatimit shtesë në lidhje me kontestin për mos pranimit të shpenzimeve të automjeteve (mjeteve themelore) dhe qarkullimi shtesë nga analiza materiale, të cilat vërtetohen si të bazuara, por nuk ka sqaruar asgjë për gjobën e shqiptuar në shumë prej 5,951.81 euro.

Gjykata vlerëson se arsyetimi i vendimit kontestues është i mangët dhe se nuk janë trajtuar në mënyrë të plotë të gjitha çështjet dhe faktet vendimtare që lidhen me këtë konflikt administrativ. Nga shqyrtimi i vendimit kontestues rezulton se ai përmban të meta, të cilat qëndrojnë kryesisht në faktin se arsyetimi është i pamjaftueshëm dhe jo i plotë. Në vendimin e kontestuar nuk janë dhënë arsye të qarta mbi faktet vendimtare që kanë përcaktuar marrjen e këtij vendimi. Nga analiza e vendimit kontestues, gjykata konstaton se e paditura nuk ka dhënë arsyetim të mjaftueshëm për gjetjet dhe për bazën e vendimit të ZGJONA-s, por është kufizuar vetëm në referimin e përgjithshëm se përgjigja gjendet në vendimin nr. 492/2021. Ky dispozitiv është në kundërshtim me dispozitat e LPPA-së, aq më tepër kur kjo çështje nuk është trajtuar fare në arsyetimin e vendimit. Vendimi nr. 492/2021 shqyrton ankesën ndaj raportit të kontrollit, dhe jo

ankesën ndaj vendimit të Zyrës për Gjopa dhe Ndëshkime Administrative nr. 2665/2021, çka tregon se një pjesë e vendimit nuk është arsyetuar fare.

Gjykata vlerëson, se arsyetimi i vendimit nuk përmban arsye mbi faktet vendimtare, të vlefshme për zgjidhjen e drejtë të çështjes në shqyrtim dhe nuk përmban të dhëna lidhur me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur dhe provat me të cilat është vërtetuar gjendja faktike nuk janë vërtetuar, si dhe nuk përmban arsye lidhur me thëniet në padinë e paditësit. Në këtë drejtim gjykata konsideron se pa dëshmi të mjaftueshme, provuese për çështjet kontestuese dhe pa e mbështet vendimin kontestues në prova të cilat e vërtetojnë qartë gjendjen faktike e paditura nuk ka mundur të nxjerr konkluzion të drejtë në këtë çështje administrative. Gjykata obligon të paditurën që në ri procedurë të arsyeton qartë dhe sipas dispozitave ligjore të lartcekura si dhe ti përgjigjet pretendimeve të paditësit të cilat në vendimin kontestues fare nuk janë elaboruar.

Të metat e lartcekura janë të tilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, prandaj gjykata në rivendosje e obligon të paditurën që të deklarohet lidhur me çështjet e theksuara më lart.

Bazuar në nenin 81.F par.2 të ligjit Nr.04/L-102 të Udhëzimit Administrativ për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr.03/L-222, “*Administrata tatimore, doganore ose ndonjë administratë tjetër kompetente do të bart detyrimin e vërtetimit të fakteve të cilat e mbështesin vendimin dhe kundërshtojnë kërkesën e tatimpaguesit*”. Neni 7, paragrafët 1 dhe 3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 parasheh se: “*Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë me të cilat konstatohen faktet e tilla*”.

Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative, në përputhje me nenin 43, paragrafi 1, të LKA-së. Në bazë të këtij parimi, gjykata e ka të pamundur të vendosë në mënyrë meritore në këtë konflikt administrativ për arsye se ekzistojnë të meta që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar.

Andaj gjykata aprovon padinë e paditësit, anulon aktvendimin e kontestuar dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Sipas nenit 43, paragrafi 2, të LKA-së, përcaktohet se: *“Nëse gjykata konstaton se konflikti administrativ nuk mund të shqyrtohet në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative për shkak se në pikëpamje të fakteve të vërtetuara ekzistojnë kontradikta në akte, gjë që në pikat esenciale nuk janë vërtetuar plotësisht, ose konstaton se në procedurën administrative nuk janë respektuar rregullat e procedurës, që do të kishin rëndësi për zgjidhjen e çështjes, gjykata do të anulojë me aktgjykim aktin e kontestuar administrativ. Në një rast të tillë, organi kompetent ka për detyrë të veprojë ashtu si është caktuar në aktgjykim dhe të nxjerrë akt të ri administrativ”*. Andaj, gjykata bazuar në autorizimet nga neni 43, paragrafi 2, të LKA-së e detyron të paditurën që në ri-procedurë të veprojë sipas vërejtjeve të dhëna në arsyetimin e këtij aktgjykimi. Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar edhe në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Vendimin që secila palë të bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga sa u tha më lart, gjykata, konform nenit 43, paragrafi 2, dhe nenit 46, paragrafët 1, 2 dhe 3, të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.624/22, datë 18.09.2024

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.